



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

KURSE TRAJNIMI NË INDI PËR VITIN 2019-2020

Në kuadër të “Programit për Bashkëpunim Teknik dhe Ekonomik Indian (ITEC), për periudhën 2019 – 2020, Qeveria e Indisë i ofron palës shqiptare bursa për pjesëmarrje në kurse trajnimi afatshkurtra ose afatgjata në institucionet indiane për vitin 2019 – 2020. Kandidatët e interesuar për aplikim duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

1. Të jenë punonjës të shërbimit civil, punonjës të sektorit publik, privat, universiteteve dhomës së tregtisë dhe industrisë;
2. Të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
3. Të jenë të moshës 25-45 vjeç;

Referuar listës së trajnimeve të paraqitura në faqen web nga organizatorët e programit ITEC, kandidatët e interesuar për të marrë pjesë në këto kurse duhet të plotësojnë formularin e aplikimit që gjendet në faqen: www.itecgoi.in. Pas përfundimit të aplikimit online për një nga kurset e ofruara, kandidati/kandidatja duhet të dorëzojë me postë një kopje të aplikimit në Drejtorinë e Integrimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë 3 muaj para datës së fillimit të kursit të trajnimit. Afati i fundit për aplikim është data **13 gusht 2019, ora 16:00**. Lista e kurseve të ITEC gjendet në faqen website

<https://www.itecgoi.in>.

Të gjitha shpenzimet për transportin ndërkombëtar, shpenzimet për tarifat e kursit, shpenzimet për akomodimin dhe ushqimin mbulohen nga Qeveria e Indisë.

Për një informacion më të hollësishëm lidhur me llojin e kurseve që ofrohen dhe mënyrës së plotësimit të formularit të aplikimit online, referojuni adresave së internetit në vijim:

<https://www.itecgoi.in/index.php>

https://www.itecgoi.in/how_to_apply.php

https://www.itecgoi.in/terms_and_conditions.php

<https://www.itecgoi.in/streamlist.php?salt3=63f646f7a12019-2020>

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS